



AKADEMIK **PETRAQ** **PILIKA** - themelues i shkollës shqiptare të matematikës

Konferencë shkencore *in memoriam*,

me rastin e 100-vjetorit të lindjes

Dhe ceremonia e dorëzimit të diplomave fituesve
të çmimeve shkencore të veçanta *Pilika*

3 qershor 2024



I. Konferenca

Fjala e hapjes dhe drejtimi i seancës nga prof. Fatmir Hoxha;

Po i jap fjalën Kryetarit të Akademisë së Shkencave Skënder Gjinushi për të mbajtur referatin:

Petraq Pilika, Themeluesi i shkollës shqiptare të matematikës

Tani e merr fjalën prof. dr. Viktor Kabili, një nga ish-studentët e parë të akad. Pilikës

Prof. Viktor Kabili, Petraq Pilika në kujtesën e një prej ish-studentëve dhe kolegëve më të hershëm;

Tani e merr fjalën prof. Qamil Haxhibeqiri, Anëtar korrespondent i ASHAK, për të dhënë disa kujtime me prof. Pilikën. Prof. Qamili ka qenë asistent i prof. Pilikës në Universitetin e Prishtinës, kur prof. Pepi mbante ligjërata atje.

Anëtar korrespondent i ASHAK. Qamil Haxhibeqiri, Një kujtim nga ish-asistenti i prof. Pilikës

Prof. Kedhi është një nga studentët e parë të prof. Pilikës, jeton me gruan në Belgjikë dhe ka dërguar disa kujtime për profesorin, të cilat do t'i lexojë prof. Artur Baxhaku, Përgjegjësi aktual i Departamentit të matematikës.

Prof. Vasillaq Kedhi, Një përshëndetje në nderim të akad. Petraq Pilikës;

Tani do përshëndesë nga Selaniku, prof. Misheli Fundo, një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të prof. Pepit, veçanërisht në lëndën e Teorisë së Funksioneve të Variablit Real. Prof. Pepi e ka dashur, vlerësuar dhe mbështetur shumë Mishelin për talentin dhe punën e madhe që kryente në katedër.

Prof. Mishel Fundo (online) për profesor Pepin

Profesor Pepi ka qenë një njohës shumë i mirë i fizikës dhe ka botuar, me bashkautorë, në fillimet e punës së tij, edhe tekste Fizike për studentët. Gjithashtu, ai ka ligjëruar analizën Matematike edhe në degën e Fizikës. Akad. Florani do japë disa nga përshtypjet e tij, si ish student dhe ish koleg i prof. Pepit.



Akad. Floran Vila: Pilika dhe Fizika

Në emër të familjes përshëndet vajza e prof. Pilikës, Leda Mëhilli Pilika. Leda ka mbaruar studimet për Matematikë në Paris ku jeton me bashkëshortin dhe dy fëmijët dhe punon në aplikimin e metodave matematike në Financë.

Fjalë falënderimi nga përfaqësues i familjes Pilika;

II. Ceremonia e dorëzimit të çmimeve

Përpara ndarjes së çmimeve, akad. Neki Frashëri flet për çmimin Pilika, për tri kategoritë:

Çmimi i veçantë shkencor Pilika, për doktoratën më të vlerësuar të studiuesve të rinj shqiptarë, mbrojtur e publikuar gjatë periudhës 2010-2023 – i jepet prof. asoc. Besiana Çobani.

Njohja me motivacionin nga akad. Neki Frashëri;

Besiana Çobani përshëndet online, nga jashtë shteti

Çmimi i veçantë shkencor Pilika për punimin më cilësor të realizuar nga studiues shqiptarë brenda e jashtë vendit i jepet prof. asoc Kastriot Zoto. Njohja me motivacionin nga prof. Fatmir Hoxha, dorëzimi i diplomës nga Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja;

Përshëndetja në sallë e K. Zotos

Çmimi i veçantë shkencor Pilika për studiuesin më të suksesshëm të karrierës në matematikë dhe/ose në shkencat kompjuterike brenda e jashtë vendit i jepet prof. Aleko Minga. Njohja me motivacionin nga akad. Qamil Haxhibeqiri, dorëzimi i diplomës nga kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Skënder Gjinushi; **prof. A. Minga përshëndet me një mesazh zanor.**



Prof. dr. Fatmir Hoxha

Fjala e Hapjes

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi dhe nder i veçantë për mua, të hap Konferencën Shkencore, in memoriam, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademikut dhe profesorit tonë të paharruar Petraq Pilika.

Në këtë konferencë na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre, akademikë e profesorë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, ish studentë dhe ish kolegë të akademik Pilikës, pedagogë, mësues e studentë.

Në veçanti na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, prof. Mehmet Kraja dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Skënder Gjinushi.

Na nderojnë gjithashtu familjarë, të afërm dhe miq të akademik Pilikës.

Pikërisht sot 100 vjet më parë u lind në Korçë Petraq Pilika, i cili do të linte gjurmë të pashlyeshme në historinë e arsimit shqiptar në përgjithësi dhe atij matematik në veçanti.

Ne që kemi patur fatin ta njohim prof. Pepin si pedagog, si koleg, si drejtues e si njeri, e kujtojmë atë parimor, me autoritet, pasionant, me gjykim të mprehtë e logjikë të pakundërshtueshme, që respektohej nga të gjithë. Edhe ai i respektonte të tjerët, veçanërisht ai respektonte talentin, dijen, studimin dhe mbi të gjitha, ndershmërinë.

Figura shumë dimensionale e profesor Pilikës dhe vepra e tij për matematikën do mbeten të gjalla në mendjet dhe zemrat tona.

Duke cituar prof. Aleko Mingën në një shkrim për akademik Pilikën :

Ai i takon një plejade njerëzish që e nderojnë Shqipërinë dhe frymëzojnë brezat për përballimin e detyrave të kohës. Ai do mbetet në “Yjësinë ” e personaliteteve më të shquara shqiptare të arsimit dhe të shkencës. (fund i citimit)

Në këtë konferencë folësit do hedhin dritë mbi jetën dhe veprën e akademik Pilikës, cilësitë e tij si pedagog e shkencëtar, drejtues dhe njeri me vizion.

Për të përjetësuar kontributin e jashtëzakonshëm të akademikut Petraq Pilika, në 100-vjetorin e lindjes së tij, me propozimin e Komisionit të Matematikës dhe Informatikës, Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë themeloi çmimin “Petraq Pilika», për Matematikën dhe Informatikën, i cili do jepet këtë vit në Matematikë, për tri kategori:

Për Doktoratën më të mirë, për Artikullin më të mirë shkencor dhe për Karrierën. Juritë e ngritura për këtë qëllim kanë përcaktuar fituesit.

Ceremonia e dorëzimit të Diplomave për çmimet përkatëse do zhvillohet pas Konferencës.

Në fund do ketë një koktej në oborrin e Akademisë, ku jeni të ftuar të merrni pjesë.

Tani i jap fjalën Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Skënder Gjinushi, për të mbajtur Referatin: *Petraq Pilika themeluesi i shkollës shqiptare të matematikës*



Akademik Skënder Gjinushi

Fjala në konferencën për matematikën dhe ceremoninë e ndarjes së çmimeve të veçanta shkencore *Pilika*

Në 100-vjetorin e lindjes së akad. Petraq Pilika

Të nderuar pjesëmarrës,

Të nderuar familjarë të prof. Petraq Pilikës,

Të nderuar akademikë, profesorë, studiues, përfaqësues të të gjithë brezave të matematikanëve,

Ne sot jemi mbledhur për të nderuar e përkujtuar figurën dhe jetën e një matematikani të madh, të themelartit të shkollës së parë të matematikës shqiptare; të profesorit të dhjetëra brezave të mësuesve e matematikanëve; të drejtuesit historik të katedrave të matematikës; të personalitetit e njeriut me karakter po aq të fortë e rigoroz sa dhe shkenca e logjika matematike, anëtarit të Akademisë sonë të Shkencave Petraq Pilika.

Profesor Pepi, siç e thërrisnin më së pari miqtë e kolegët më të afërt e më tej edhe tërë ish-studentët e studentet, për të shprehur mirënjohjen e respektin e veçantë që ai impononte, lindi në Korçë 100 vjet më parë, më 3 qershor 1924.

Pjesëmarrës aktiv në lëvizjen nacionalçlirimtare, ai, menjëherë pas çlirimit, iu kushtua pasionit të tij për matematikën, së cilës iu përkushtua tërë jetën. Pasi kreu studimet e larta në universitetin *Lomonosov* në vitet 1946-1951, që në moshën 27-vjeçare, mori përsipër barrën e rëndë për drejtimin e katedrës së matematikë-fizikës pranë Institutit të Lartë Pedagogjik dhe, pak vite më vonë, me themelimin e Universitetit të Tiranës më 1957, emërohet përgjegjës i katedrës së matematikës.

Ndërkohë që shkolla jonë e matematikës po hidhte hapat e parë institucionale, profesor Pepi vazhdoi kualifikimin e tij profesional duke kryer e mbrojtur me sukses,

pa shkëputje nga puna, *disertacionin në fushën e analizës funksionale* në një nga shkollat më me autoritet të asaj kohe, me drejtues teze akademikun Nikolski, bashkudhëtar i Kolmogorovit.

Kryerja e doktoratës në distancë në matematikë teorike, udhëhequr nga një nga matematicienët e rangut botëror të kohës; si dhe botimi i rezultateve të saj në buletin e Akademisë së Shkencave të Moskës, ishin rezultat i talentit të veçantë të të riut Pilika që tregonin se shkolla shqiptare tashmë kishte rënë në duar të sigurta. Këtë talent e investim të tij profesori e vuri pa asnjë rezervë në funksion e *drejtim të katedrës së matematikës së specialitetit*, të cilën ai e drejtoi për 40 vjet me radhë.

Angazhimi në kërkimin shkencor ishte një zgjedhje e sakrificë e tij për kushtet e kohës, i udhëhequr nga bindja se një drejtues duhet më së pari të ndjekë ritmet e zhvillimit shkencor për të parë qartë se ku duhej mbërritur, *për të siguruar që formimi matematik i brezave të rinj të përshtatej në vazhdimësi me kërkesat e kohës*, jo vetëm në arsimin e lartë, por edhe në arsimin bazë e atë të mesëm.

Profesor Pepi përmendte shpesh se arsimi i mesëm përcakton nivelin kulturor të një vendi, duke e ditur mirë se formimi matematik përbënte komponentin kryesor, e për këtë *duhej një shkollë e fortë matematike*, të cilën ai arriti ta krijojë, ta rrisë dhe forcojë. Ky vizion i profesorit bëri që *shkolla e matematikës të mos ndodhej para të papriturave, por t'u pararendte sfidave të mëdha*.

Ai e kuptoi i pari se shkolla jonë nuk duhej të formonte vetëm mësues, por edhe matematikanë; se *matematika nuk shërbente vetëm për mësimdhënie, por edhe për zbatim*; se *kërkimi shkencor nuk qe një luks, por një domosdoshmëri për të ndjekur të rejtat shkencore, logjikë që çoi në krijimin për herë të parë të degës së matematikës speciale*. Petraq Pilika pati kurajën dhe mbështeti me pasion që në vitet 1960 *nevojën e ngritjes së qendrës së matematikës llogaritëse dhe më 1966 kryesoi delegacionin negociator në Kinë për ngritjen e kësaj qendre, duke hedhur kështu edhe themelet e shkencës e të degës së informatikës në Shqipëri*.

Profesori kuptoi në kohën e duhur *nevojën e ballafaqimit të shkollës shqiptare me atë perëndimore, se shkolla jonë po e mbyllte ciklin e përvojës së përfituar nga modeli lindor edhe për shkak të ndryshimit të kursit politik në raport me Lindjen; se matematika kishte hyrë tashmë në fazën e modernizimit të saj; se shkolla franceze ishte në avangardë të këtyre ndryshimeve e se shkolla jonë duhej të hapej ndaj saj*.

Është ky vizion e kjo këmbëngulje e tij; personaliteti i pakundërshtueshëm që kishte, që mundësoi të realizoheshin një numër kualifikimesh pasuniversitare në Francë, në matematikë, në një kohë që vendi ishte ende mjaft skeptik e i mbyllur ndaj shkollave perëndimore. Për të

shfrytëzuar në maksimum dijen e përfituar dhe për transmetimin sa më të mirë të saj ndër kolegë dhe në programet e reja, profesori *nxiti e mbështeti krijimin e funksionimin e grupeve të kërkimit shkencor në fushat kryesore të matematikës dhe drejtoi organizimin e konferencave të para shkencore në nivel kombëtar në matematikë në vitet 1984 e 1986, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, për të mundësuar paraqitjen e rezultateve të reja e për të nxitur debatin shkencor.*

Me siguri profesori është ndjerë shumë krenar kur, me hapjen e vendit pas vitit 1990, të rinjtë shqiptarë, si ata me arsim të mesëm dhe ata që kishin kryer arsimin e lartë në degën e matematikës a degët ku matematika ishte lëndë bazë, e *ndienin veten superiorë në raport me bashkëmohatarët kudo në Europë, e kjo s'do të arrihej pa kontributin e profesor Piliqës, pa disa cilësi të spikatura e të rralla të tij.*

Profesori *kriter të parë për vlerësimin e përzgjedhjen e kolegëve të tij e të studentëve kishte aftësinë, e me këtë nuk bënte kurrë kompromis. Ishte ky tipar i tij që bëri që katedrat e matematikës të rreshtoheshin ndër katedrat elitare; që përkrah profesorit ndër vite të kontribuonin si një ekip personalitete si profesorët Baxhaku, Kraja, Bukuroshi, Turdiu, Fundo, Naqo e Çifligu, për të vazhduar me brezin pasues, Karçanaj, Berdulla, Fundo, Petro, Kedhi, Malita, Ruseti, Kabili, Haxhimusai etj., duke dhënë modelin e një bashkëpunimi shembullor, model i cili kulmon me binomin legjendë për të gjithë brezat e matematikës, të profesor Pepit e profesor Lekos, dy personalitete shumë të ngjashëm për nga talenti e dashuria për matematikën, për nga vizioni e përkushtimi për të dhe shumë plotësues për nga karakteri e temperamentit.*

Për të kuptuar *rolin e pazëvendësueshëm të këtij binomi në konsolidimin e shkollës së matematikës, në moscenimin e formimit matematik prej klisheve revolucionarizuese të kohës, mjafton të kujtojmë një debat të vitit 1969, kur sapo kishte dalë direktiva për shkurtimin me një vit të degëve universitare në tërësi, përfshirë atë të matematikës, debat i zhvilluar në mjediset e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ku ky vendim u parandalua me argumentet e paraqitura me qetësinë e elokuencën e prof. Lekos, e të mbrojtura me tonin e prerë e të vendosur të prof. Pepit.*

Profesori ishte përkrahësi me i zjarrtë i studentëve të rinj; ai nuk mjaftohej që thjesht t'i përkrahte ata, por punoi në vazhdimësi për nxitjen, evidentimin e përzgjedhjen e më të talentuarve që në bankat e shkollimit parauniversitar. Me nismën e tij e të kolegëve të tij, më 1975 u eksperimentua organizimi i olimpiadave të matematikës prej katedrës së matematikës, përvojë e cila rezultoi e suksesshme duke u kthyer në një veprimtari të përvitshme kombëtare si dhe i parapriu futjes së matematikës moderne që në klasën e parë, duke mbështetur grupin e prof. Dedejt. Janë unikale inkursionet e profesorit në

gjimnazet e Shqipërisë për të parë nga afër e nxitur më të talentuarit të studionin për matematikë. Aq e njohur u bë kjo iniciativë e profesorit, sa filloi të shprehej edhe ndonjë xhelozë se profesori po dëmtonte degët e tjera duke marrë më të aftët në matematikë.

Profesori, gjatë gjithë jetës, ushtroi me shumë zell e pasion detyrën e pedagogut në Shqipëri e në Kosovë. Tekstet e tij, si *Bazat e analizës matematike*, *Kursi i algjibrës së lartë*, *Teoria konstruktive e funksioneve*, *Ushtrime e problema matematike*, ishin manuallet bazë për formimin matematik të mësuesve e matematikanëve të ardhshëm, pa harruar disiplinën e tij të zemrës *Teoria e funksionit të variablit real*, lëndë të cilën ai e jepte me një pasion të veçantë. Rrallë një lektor e përjeton dhe harxhon aq energji sa prof. Pepi për leksionet e *TeFeVeRes*, siç thirrej shkurt lënda e tij tingulli onomatopeik i së cilës përkonte me energjinë e plastikën e profesorit në leksion e emocionin e dridhjen e studentëve në provimin më të vështirë.


Për kontributet e tij si pedagog e matematikan profesori meritoi e fitoi titullin *docent* më 1955; pas gradës së *kandidatit të shkencave* më 1961, në vitin 1972 fitoi titullin *profesor*, për t'u zgjedhur *anëtar korrespondent* i Akademisë së Shkencave që me themelimin e saj e fituar titullin *akademik* më 1980.

Për kontributin e jashtëzakonshëm si *themelues i katedrës së parë të matematikë-fizikës*; *i katedrës së matematikës së specialitetit*; *i shkollës shqiptare të matematikës*; si *bashkëthemelues i Universitetit të Tiranës dhe i Akademisë së Shkencave*; për *veprimtarinë e tij mbi 40-vjeçare në lëmin e arsimit dhe shkencës*, prof. Pilika është nderuar me disa tituj të lartë. Krahas *Medaljes për kontribut të shquar për çlirimin e Atdheut*, prof. Pilika ka fituar titujt *Qytetar nderi i Korçës*, *Mjeshtër i Madh* dhe *Mësues i Popullit*. Salla e rektoratit e Universitetit *Fan S. Noli* të Korçës mban emrin e këtij biri të shquar të këtij qyteti, të dalluar për një traditë të fortë për arsimimin në tërësi dhe matematikën në veçanti, profesor *Pilikës*.

Për gjithë këtë kontribut të pakrahasueshëm, për këtë veprimtari të çmuar, profesorit do t'i jenë gjithnjë mirënjohës brezat e tërë ish studentëve e studenteve, kolegët e tij bashkudhëtarë e pasues, tërë shoqëria e matematika shqiptare.

Në mënyrë të veçantë Akademia e Shkencave do të krenohet në vazhdimësi që pati në radhët e saj që nga themelimi profesor Petraq Pilikën, e për të shprehur sadopak mirënjohjen tonë institucionale e përjetësuar këtë figurë në këtë 100-vjetor të lindjes, u caktua si çmim i veçantë çmimi *Pilika*, në matematikë-informatikë.

I paharruar emri e vepra e prof. Petraq Pilikës!



***Kujtime* të prof. dr. Viktor Kabili** **për P. Pilikën**

Arsimi i lartë matematik në Shqipëri është i lidhur ngushtësisht me emrin e profesor Petraq Pilikës. Po e nis nga koha kur isha student i tij. Unë dhe të gjithë ata studentë që kanë patur fatin të ndjekin leksionet e profesor Pepit nuk mund të harrojmë atë shpjegim, atë ligjërime plot pasion e me gjallëri. Ai të bënte për vete. Mënyra si i trajtonte idetë të hapte horizont. Ajo mënyrë leksioni të rrëmbente, ishte e veçantë, ishte dhunti e profesorit. Ajo i rridhte së brendshmi, nuk mund të imitohej apo të përvetësohej nga të tjerët.

Edhe sot kur takon studentë të profesorit ata flasin me admirim për të.

Po, profesori ishte shkencëtar. Profesor Pepi ka kryer studimet në Universitetin e Moskës me profesorë të shquar të nivelit botëror.

Shkollimin në atë universitet profesori e shfrytëzoi maksimalisht për t'u formuar me kulturë matematike të thellë. Edhe më pas, gjatë gjithë jetës së tij, profesor Pepi punoi me zell e me përkushtim për matematikën.

Profesor Pepi mori edhe doktoratën në atë Universitet duke punuar nga Shqipëria, pa shkëputje nga puna. Ai vazhdoi të arrinte rezultate të reja në fushën e vet edhe pas marrjes së gradës shkencore. Vite më vonë, në një simpozium ndërkombëtar për fushën ku kishte punuar profesor Pepi, u përmendën edhe punimet e tij si arritje të rëndësishme në këtë fushë.

Por, për profesor Pepin, veprimtaria shkencore ishte e domosdoshme për të gjithë pedagogët e katedrës. Me nismën e tij, katedra e matematikës, e para, organizoi 2 seminare shkencore që zhvilloheshin në seanca të përjavshme. Profesori udhëhoqi disertantë dhe nxiti pedagogë të katedrës duke i caktuar vetë të përvetësonin disiplina të caktuara për t'i futur në programin mësimor për të rritur nivelin matematik të studentëve.

Profesor Pepi shikonte gjithmonë për arritje të reja dhe për një formim matematik të lartë. Ai shfrytëzoi një fjalim të Enver Hoxhës që vlerësoi rolin e matematikës për progresin tekniko- shkencor dhe ia arriti të lejohej të zgjidhte nxënësit më të talentuar në matematikë.

Profesori ishte vizionar. Me iniciativën e tij u formua profili 5 vjeçar i matematikës. Që këndej dolën matematicienë të mirëformuar, elitë e matematikës. Krijimi i Qendrës së Matematikës Llogaritëse, që në fillim ishte në varësi të katedrës, ishte një tjetër arritje e profesorit.

Të dyja këto rritën ndjeshëm edhe zbatimin e metodave matematike në degë të ndryshme të ekonomisë: në industri, në tekstile, në sektorin e naftës, në pasurimin e mineraleve, etj.

Një tjetër merak i profesor Pepit ishte zbulimi i talenteve të reja e për këtë do ishin olimpiadat e matematikës. Profesori përzgjedhi brenda katedrës pedagogët dhe orientoi saktë organizimin e këtij aktiviteti që më vonë u bënë të përvitshme.

Por, për të arritur këto e të tjera, nuk ishte e lehtë. Duhet të përballeshe edhe me qëndrime të kundërta nga persona të tjerë dhe me autoritet. Por profesor Pilika, i bindur në idetë e tij të drejta dhe se këto ishin në dobi të vendit, po aq sa ishte logjik, i mprehtë, shkencëtar, i ndershëm po aq ishte edhe i guximshëm dhe arriti aty ku synonte.

Figura e profesor Pilikës, akademikut, mësuesit të popullit, lektorit të rrallë, ka frymëzuar breza të tërë se si duhet të studiojnë, si duhet të punojnë.

Të gjithë ne këtu jemi besimplotë se vendi ynë do ketë njerëz të zotë, matematicienë të zotë; por, a do ketë një profesor Petraq Pilikë të dytë!?



Qamil Haxhibeqiri

Përkujtim

për akademik Petraq Pilikën (1924 - 2009)

Sot jemi mbledhur këtu të përkujtojmë akademikun profesor Petraq Pilika, themeluesin e shkollës shqiptare të matematikës, me rastin e 100 vjetorit të lindjes së tij.

Ky përkujtim për prof. Petraq Pilikën nuk është thjeshtë një rast për të ripërtërirë kujtimin e ndritur për të, që koha s'ka fuqi ta zbehë në mendjen dhe shpirtin e të gjithë atyre që patën fatin ta njohin e ta çmojnë këtë njeri të mrekullueshëm, por është edhe një përmbushje e një detyrimi për të shprehur nderimin dhe respektin më të madh për trashëgiminë e vyer që ai u la brezave, mirënjohjen më të thellë për veprën e tij. Njëherësh kënaqet edhe një dëshirë e gjithmbarshme për të ndarë mbresa e përjetime që, padyshim, do ta plotësojnë figurën e tij, e cila është dhe do të mbetet shëmbëlltyrë e përkryer përkushtimi ndaj idealeve të larta e fisnike.

Në vitin e largët shkollor 1974-75, pas mbarimit të studimeve pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, emërohem asistent në Departamentin e Matematikës të FSHMN të Universitetit të Prishtinës. Në këtë kohë profesor Pepi, si edhe disa profesorë tjerë nga Universiteti i Tiranës, kishin ardhur në Prishtinë që me punën e tyre të pakursyer të ndihmojnë kolegët e tyre në ngritjen e brezave të rinj të matematikanëve kosovarë. Me këtë rast pata fatin të isha asistent i profesor Petraqit i cili mbante leksionet nga lënda "Analiza III" ku studioheshin funksionet me ndryshore reale.

Angazhimin e tij, që njohuritë matematike të na i bëjë sa më të kuptueshme dhe të pranueshme, duke mos kursyer asgjë nga munda dhe koha e tij, i kujtoj gjithnjë me prioritet. Si asistent i ri e kam pasur gjithnjë përkrahjen dhe ndihmën e pakursyer të prof. Petraqit në çdo drejtim. Edhe sot e kësaj dite i ruaj me nostalgji dy vëllimet e dispencës "Teoria e funksioneve të variablit real" të Natansonit të përkthyer dhe të

përshtatura në gjuhën shqipe nga profesor Pepi, të cilat asokohe mi dhuroi. Ai pa përtësë dhe me kënaqësi gjente kohë të më ndihmonte në tejkalimin e vështirësive të rastit që më paraqiteshin në atë kohë duke u përgjigjur me mirësi dhe qartësi në pyetjet që i parashtroja.

Me ftesën e prof. Petraqit kam qëndruar në vizitë studimore njëmuajore në Universitetin e Tiranës në vitin 1977. Ishte kjo vizita e parë e Tiranës në ato kohë të vështira të cilën e kujtoj gjithnjë me nostalgji. Për të gjitha këto i jam falënderues përjetësisht profesor Pepit.

I pajisur me dije dhe kulturë matematikore të gjerë dhe të thellë, me forma të komunikimit shembullor, gjithnjë rrezatoi energji pozitive të absorbueshme për të gjithë, e posaçërisht për të rinjtë dhe studentët. Vuri gurë themelet e matematikës tek ne shqiptarët. Vepra e tij shkencore u respektua kombëtarisht e ndërkombëtarisht. Krijoi dhe pajisi me kulturë matematike shumë breza të cilët do të vazhdojnë misionin e rrezatimit dhe përhapjes së dijeve matematike nëpër të gjitha viset e banuara me shqiptarë. Si pedagog i mirëfilltë u dëshmuua me përpjekjet që matematikën për studentë ta bënte sa më të kuptueshme dhe më të lehtë. Me qëndrim e dashuri prej prindi ndaj studentëve, parapëlqente jo distancë por afërsi, jo dekret e as imponim por respekt, dashuri dhe përkushtim ndaj problemeve të tyre.

Profesor Petraqi ishte udhërrëfyes dhe edukator i shumë brezave të matematikanëve, ishte fjalëmbël dhe i afërt me studentët e tij, punëtor i palodhshëm i cili me mësimet e tij ngriti gjenerata të tëra matematikanësh. Me butësinë e tij me mendjemprehtësinë e tij, me talentin e tij të rrallë ishte shembull se si duhet të dukej intelektual, profesori e shkencëtari. Të tillë do ta kujtojnë përjetë profesor Pepin ish studentët e tij si dhe të gjithë ne që patën fatin ta njohim dhe të bashkëpunojmë me të.

Njerëzit si akademik Petraq Pilika do të rrojnë në kujtesën e kombit si pika të ndritshme të referimit në rrugën e mundimshme të përparimit të tij.

Për të gjitha këto i takon një falënderim i përjetshëm veprës dhe angazhimit të akademik Petraq Pilikës.



Përshëndetja

e prof. dr. Vasillaq Kedhi,

e lexuar nga prof. dr. Artur Baxhaku

Falënderoj organizatorët për ftesën që të marr pjesë në këtë ceremoni përkujtimi të profesorit tonë të paharruar, akademikut Petraq Pilika. Në pamundësi që të jem i pranishëm në këtë veprimtari po dërgoj një shkrim mirënjohjeje dhe vlerësimi të lartë për veprën e këtij personaliteti të shquar të Universitetit të Tiranës dhe arsimit shqiptar në përgjithësi. Jam i sigurt se grupi organizator, e ka paraqitur tashmë veprimtarinë dhe vlerat e prof. Pilikës në mënyrë sa më të plotë e prandaj unë do të kufizohem në disa përjetime personale gjatë periudhës së studimeve dhe më tej si pedagog në katedrat e matematikës.

Studimet në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës në degën matematikë-fizikë i fillova në shtator 1956. Ishte një botë e re, nga njëra anë më e lirshme sepse gjatë orëve të mësimit kishte vetëm shpjegime por nuk kishte nota. Nga ana tjetër, më e shtrënguar dhe e lodhshme sepse në një javë bëheshin rreth 26 orë pesëdhjetë minutëshe matematikë. Pra, një ndryshim shumë i madh në ngarkesën e studentit. Por, për fat të mirë, pedagogët shpjegonin shumë mirë.

Prej studentëve të viteve më të larta kishim dëgjuar se “me prof. Pilikën s’ka shaka, ai ka kërkesa të forta”. Ashtu na doli vërtet, por, cili ishte ky pedagog që kështu, disi veçohet? Qyshse filluan leksionet e algjebërës u shfaq mënyra energjike por shumë e qartë e paraqitjes së lëndës. Profesori, i zhytur në abstraksionin e natyrshëm të matematikës, me një pasion karakterizues, shpjegonte sesi kushtëzimet logjike pasqyroheshin në aparatit matematik. Ai zbërthente me kujdes çdo detaj teorik dhe teknik në vërtetimin e pohimeve duke rritur ndjeshmërinë e tonalitetit të zërit në pjesët kyç dhe më të vështira të vërtetimeve. Në këtë atmosferë të elektrizuar që krijonte në leksionet e veta prof. Pilika, të gjithë ne studentët përqendroheshim tërësisht në ndjekjen e shpjegimeve aq sa, shpesh të përhumbur në atë atmosferë, harronim të merrnim shënime. Në ato kohëra akoma nuk ishin përgatitur tekstet e lëndëve matematike. Mbas disa javësh profesori na bëri një kontroll me shkrim. Për të

na dhënë rezultatet na thirri të shkonim një mbasdite në një sallë (auditor) të fakultetit. Kur kthente detyrat, çdo studenti i tregonte gabimet e bëra dhe i shpjegonte me hollësi sesi duhej të ishte përgjigjja e rregullt. Pra, prof. Pilika vërtet ishte kërkues por, së pari ai bënte përpjekjet maksimale për shpjeguar qartë çdo hollësi të lëndës dhe për të na mësuar sesi t'i shtrojmë vetes pyetje gjatë studimit të lëndës. Kjo mënyrë pune ishte njëherësh mësimi i parë bazë profesional mbi sjelljen ndaj nxënësve në të ardhmen tonë si mësues, thënë shkurt: "Para se të kërkosh duhet të japësh".

Në të katër vitet e shkollimit, një nga lëndët bazë të formimit teorik profesional na e ka zhvilluar Prof. Pilika. Pra, është ky profesori që, si me praninë e tij kohore në auditor, me aftësitë e tij profesionale dhe cilësitë njerëzore, ka ndikuar më shumë në formimin tonë profesional. Në qoftë se imagjinojmë një kod gjenetik profesional të njerëzve, atëherë me siguri, për të gjithë ne ish studentët e prof. Pilikës, analizat do të tregonin origjinë të përbashkët tek "trungu" (me rrënjë) Petraq Pilika.

Nuk e harroj një ndodhi fare të parëndësishme por që më la një mesazh të vlefshëm në fillimet e punës sime si mësimdhënës. Në vitin e dytë të punës pranë katedrës së matematikës, në një ore mësimi, profesori erdhi për të parë zhvillimin e mësimi prej meje. Në fund të orës unë shkova tek porta, e hapa dhe prita të dilte shefi që ishte ulur në fund të klasës. Dolën studentët dhe profesori arriti tek porta por, në vend që të dilte, me tha: "dil ti i pari, pedagogu është zot i vetëm i orës së mësimi". Nuk ka rëndësi se çfarë mendova apo veprova në atë moment, ajo që kuptova dhe ka mbetur në kujtesën time është rëndësia që i jepte ai orës së mësimi dhe dinjitetit që duhet të karakterizojë figurën e mësuesit apo pedagogut. Dinjiteti njerëzor ishte tipar thelbësor i karakterit të profesorit Pilika që, përveç vlerave të tjera, e bëri atë të respektuar e të admirueshëm për studentët dhe kolegët e tij.

Në mbledhjen e katedrës së matematikës në fillim të vitit mësimor, në shtator 1960, kur sapo kisha filluar punën pranë asaj katedre, shefi Pilika foli për detyrat e përgjithshme por, në atë mbledhje ai tha se kishte planifikuar për të kryer studime të plota pasuniversitare jashtë shtetit njërin prej anëtarëve të katedrës. Atë vit profesori kishte mbaruar me sukses studimet e veta pasuniversitare në Moskë pa shkëputje nga puna. Ai shtoi se kishte marrë garanci nga autoritetet përkatëse të vendit që edhe në çdo vit pasardhës të dërgohej një prej anëtarëve të katedrës për studime të tilla jashtë shtetit (kryesisht në Moskë). Ndërkohë, edhe dy prej anëtarëve të katedrës ishin duke kryer studime pasuniversitare në dy fusha të ndryshme të matematikës. Pra, profesor Pilika dhe, askush tjetër, kishte menduar dhe po vinte në zbatim me përpjekjet e veta, një plan zhvillimi për krijimin e një njësie mësimore dhe të kërkimit shkencor të futur

denjësisht në rrjedhat bashkëkohore të shkencave dhe didaktikës. Kuptova atë ditë se profesori ynë nuk ishte vetëm një vizionar, por ai kishte edhe vullnetin dhe energjitë për të arritur objektivin e planit të vet.

Pavarësisht se me krijimin e Universitetit plani mësimor i degës së matematikës kishte një profilizim të prirur nga mësuesia. Kishte ardhur koha për një përgatitje teorike më të thelluar dhe me shtrirje më të gjerë të matematikanëve të rinj të aftë për t'u përshtatur të punojnë mbi tema teorike ose për bashkëpunim për interpretime apo zgjidhje problemesh ekonomike apo teknike. Për këtë kërkesë të kohës, u gjet si rrugë zgjidhjeje veçimi i një grupi me numër të kufizuar studentësh me rezultatet më të larta për të ndjekur studimet përgjatë pesë viteve. Plani përkatës mësimor u pasurua me lëndë më të avancuara të atyre me natyrë të qartë teorike si dhe me disa lëndë të reja të formësuara në shekullin e njëzetë në të cilat zbatueshmëria ishte vet fryma e tyre. Pra u formësua një profil tjetër thjesht matematik.

Ideimi dhe realizimi i të gjitha ndryshimeve të mësipërme, sigurisht, përveç mendjes, kërkonin edhe veprimin e prof. Pilikës.

* * *

Mbas një periudhe fuqizimi të qendrës llogaritëse, krijimi i të cilës, pranë katedrës së matematikës ishte kontribut i prof. Pepit dhe zhvillimit të shërbimeve informatike në botë erdhi koha dhe u hap dega e informatikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Pedagogët për një periudhë fillestare dhe drejtuesit e degës ishin të gjithë të diplomuar në matematikë por me specializime në informatikë. Pra ishte edhe ky një tjetër kontribut i katedrës së matematikës të drejtuar nga prof. Pilika. Mbas mbarimit të brezit të parë të informatikanëve trupi pedagogjik u rrit gjithmonë me informatikanë të rinj.

Në të gjitha këto nisma për zhvillimin e matematikës në vendin tonë, prof. Pilika pati mirëkuptimin dhe mbështetjen e pakursyer të kolegëve prof. Qazim Turdiu, prof. Osman Kraja, prof. Shaban Baxhaku si në procesin mësimor ashtu edhe në aspekte të tjera të zhvillimit sasior e cilësor të katedrës.

Ndërmjet kolegëve të afërt të prof. Pilikës është vetëm njëri që, prej vitit 1956 kur filloi punën në katedrën e matematikës dhe, deri sa profesori doli në pension pra, afërsisht për katër dekada, i ka qëndruar përherë pranë. Ky është prof. Aleko Minga që, me aftësitë e veta të shumanshme, ka dhënë një ndihmesë lehtësuese për realizimin e ideve të përgjithshme të prof. Pilikës.

Përveç aftësive të spikatura si pedagog, shkencëtar dhe të çdo aspekti profesional, prof. Pilika ka mbetur një figurë mbresëlënëse dhe e admirueshme prej të gjithë ish studentëve të tij dhe gjithkujt që e ka njohur, veçanërisht në rrethana pune, për tiparet dalluese të karakterit të tij. Ai njeri ishte pa paragjykim, i qëndronte larg dukurive negative, kapte dhe vlerësonte më thelbësoren në problemet e zhvillimit, pasionant dhe kurajoz në mbrojtje të së drejtës, vlerësonte njeriun e punës, njeriun dinjitoz. Ne, ish-punonjësit e katedrave të matematikës i kujtojmë ato raste kur pedagogë të vjetër apo të rinj janë sulmuar politikisht prej njerëzish të ndryshëm në emër të mbrojtjes së ideologjisë partiake kur 'sebepe' në ato raste s'kanë patur aspak natyrë ideo-politike. Por, ndërhyrja kurajoze e prof. Pilikës, me forcën e gjykimeve të veta i ka neutralizuar ato.

Për 40 vjet, pa shkëputje, prof. Pilika formësoi dhe e drejtoi katedrën e matematikës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës me vullnetin, kujdesin dhe durimin e madh prej misionari. Dhe, qëllimit ia arriti në mënyrën më të mirë. Por, si për çdo gjallesë mbi tokë, edhe për njeriun ka një fund fizik. Disa ditë para se të ndërronte jetë prof. Pilika, vajta për ta parë në shtëpinë e tij. Ishte i shtrirë në shtrat. Duke e njohur karakterin e tij, u kujdesa të mos nxjerr ndonjë fjalë që nënkuptonte kurajon. Kjo do ishte fyese për të që kurajon e kishte në natyrën e vet por, flisja për tema me sa më pak ngarkesë emotive. Ndërmjet atyre ç'ka foli profesori, ruaj në mendje me zë dhe me figurë fjalët: "Vasillaq, unë nuk i trembem vdekjes". Dhe tani po them: po prof. Pilika, - keni të drejtë, ju jeni i gjallë në zemrat dhe mendjet tona dhe, vepra juaj misionare është historike në zhvillimin e shkencave matematike në Atdheun tonë.



Floran Vila

Kujtime

për akademik Petraq Pilikën

Të nderuar pjesëmarrës,

Prof. Pepin unë e kam njohur kur filloi të na jepte leksionet e Analizës matematike dhe Algjibrës, në semestrin e parë të vitit të parë të Fizikës, në 1960, kur Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës futeshin në vitin e katërt të krijimit të tyre.

Në leksionet e Analizës na mahniti. Në Gjimnaz nuk e kishim njohur gjuhën e epsilon-deltave, me të cilën ai përpiquej, me shumë pasion, të na familjarizonte. Kur fillonte leksionin, më dukej sikur futej në një botë tjetër, shkëputej nga realiteti dhe ndoshta as i shkonte mendja fare nëse ne studentët arrinim t'i shënonim ato mrekullira që ai fliste. Ishte e vështirë që të mbaheshin saktë shënime, në leksionet tija. Për të studiuar Analizën unë bleva në "Librin Sovjetik", Demidoviçin dhe Smirnovin, dy tekste me të cilat konsultohesha në raste të veçanta.

Provimi i Analizës ishte i pari në jetën tonë studentore, 6 Janar 1961. Aty kuptuam që prof. Pepi, nuk të falte në mësimin përmendsh, nuk të falte në qoftë se përgjigjeshe gabim, mjafton edhe në një koncept të vetëm, por ama që ishte themelor. Ai, për mendimin tim, i jepte rëndësi, në mënyrë absolute, arsytimit logjik.

Kalueshmëria në lëndët e prof. Pepit, kur provimi jepej për herë të parë, (flas për kohën që kam qenë unë student), ishte shumë e ulët. Notat kaluese që mbizotëronin ishin të ultat, notat mesatare ishin të rralla, ndërsa nota maksimale ishte shumë, shumë e rrallë.

Analiza matematike, e shpjeguar nga prof. Pepi, më tërhoqi jashtëzakonisht dhe i kushtova një vëmendje të veçantë. Përkundrazi, Algjebra, ndonëse e bukur, m'u duk e lehtë në krahasim me Analizën dhe nuk e mora shumë seriozisht. Dhe prof. Pepi,

me atë balancën e tij super analitike, e bëri dallimin në përgjigjet e mia në provim në këto dy lëndë. Këtu po ju them të vetmen fjali, që më tha në provimin e Algjebrës, që ishte i dyti mbas Analizës. Unë i dhashë përgjigjet për të dyja pyetjet dhe ai nuk më bëri asnjë ndërhyrje, por vetëm në fund, me atë zërin e tij karakteristik, që është i paimitueshëm, më tha: “Algjebra nuk është kaq e thjeshtë sa të është dukur ty more djalë” dhe më vuri notën 4 (5-sa në atë kohë ishte nota më e lartë). I emocionuar dola nga salla, dhe më habiti fakti se si e kuptoi që mua Algjebra më ishte dukur e thjeshtë. Por ja që “ustai”, siç i thonin, e kuptoi. Takimi i fundit me prof. Pepin ishte në provimin e shtetit të matematikës, ku mbyllëm periudhën tonë studentore.

Brezi im ka qenë me fat që ka dëgjuar që në moshën 18 vjeçare leksionet e një pedagogu 36 vjeçar, i cili 6 muaj mbasi dhamë provim në vitin e parë me të, mbrojt me sukses disertacionin në Fakultetin e famshëm të Mekanikës dhe Matematikës të Universitetit të Moskës, ku jepnin leksione korifentë që i takonin elitës së mendimit matematik botëror si Kollmogorovi, Kuroshi, Menjshovi, Gelfandi, etj.

Në vitin 1975 u caktova zv/shef i Katedrës së Fizikës së përgjithshme, detyrë që më dha mundësinë të marr pjesë në mbledhjet e Shefave të Katedrës në Dekanat si dhe të jem anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit. Dhe pikërisht në mbledhjet e Dekanatit dhe të Këshillit Shkencor, kam pasur mundësinë të dëgjoj pikëpamjet që ai shprehte në diskutimet e tij për problemet madhore të shkollimit universitar dhe të arsimit në përgjithësi.

Ai ishte idealist. Arsimin e konsideronte të shenjtë dhe ashtu si disa kolegë të paktë të tij, mbante qëndrim kritik në të gjitha rastet, kur bëheshin propozime ose veprime, që sipas tij nuk ishin në të mirën e shkollës. Në mbledhje të Dekanatit ka kritikuar Ministrinë e Arsimit, në prani të ministres të asaj kohe, në lidhje me qëndrimet liberale të drejtorëve të gjimnazeve në provimet e maturës në lëndën e matematikës, duke folur në mënyrë konkrete.

Ishte person tepër i ndershëm që nuk hezitonte të bënte edhe pohime, që në fakt e ulnin reputacionin universitar të matematikës. Mbasi atij nuk ia lejonte ndërgjegja, që të merrte vendime, për të cilat kishte bindjen që nuk mund të realizoheshin në nivelin që duhej të kërkohej.

Ishte një njeri me kërkesa shumë të larta dhe kurrë nuk lëshonte rrugë në dëm të cilësisë së mësimi dhe kërkimit shkencor.

Një herë, në vitin e tretë të matematikës, ngeli një student, që ishte edhe anëtar partie dhe me atë ngelje përjashtohej nga shkolla. I ndërhyrë, që ta merrte edhe një

herë në provim. Nuk pranoi, duke thënë që ai “nuk mund të bëhet dot një mësues matematike për shkollën e mesme”. Në mbledhje të dekanatit, dekani i tha që është vendosur zyrtarisht që të merret edhe një herë në provim. “Mirë u përgjigj, merreni, por unë nuk marr pjesë në Komision”.

Në vitin 1984 ministria vendosi, në bashkëpunim me fakultetin, që të organizohej një kurs pasuniversitar njëvjeçar me 10 mësuesit më të mirë të matematikës dhe 10 më të mirët e Fizikës, të qyteteve të ndryshme (një për qytet), të cilët më vonë do të merreshin edhe me kualifikimin e mësuesve të tjerë të këtyre lëndëve në qytetet e tyre. U vendos që nota mesatare e pranimit për mësuesit që do vinin të ishte 8. Njëra nga mësueset e matematikës, që ishte propozuar për të ardhur, e kishte mesataren 7,9. Prof. Pepi nuk e pranoi. E mori në telefon edhe sekretari i parë i rrethit përkatës, duke i thënë: “Profesor, është më e mira që kemi. Nuk kemi me mesatare më të lartë se kjo”. Dhe prof. Pepi i tha: “Më vjen mirë që keni propozuar atë që keni me mesataren më të lartë. Por nuk është e përshtatshme për këtë kurs. Ju garantoj që në kohën e kualifikimit të mësuesve, do ju dërgojmë një mësues nga një qytet tjetër, që do ta bëjë në nivelin e duhur kualifikimin në matematikë për mësuesit tuaj”.

Pra nuk e pranoi. Sot mbas 40 vjetësh, nga ky veprim i prof. Pepit, në doktoratë futen kandidatë që janë goxha poshtë këtij kriteri.

Në një debat të gjatë të bërë në Këshillin Shkencor në lidhje me statusin e katedrës, Dekani, i nderuari dhe i paharruari prof. Kolë Popa propozoi që Katedra të jetë njësi mësimore shkencore dhe administrative. Kundër doli prof. Pepi. Me një pasion shumë të madh ai filloi të argumentojë që Katedra nuk mund të jetë njësi administrative, por vetëm mësimore–shkencore. Dhe megjithëse propozimin e bëri Dekani kimist dhe shumicën absolute në Këshill e kishte Kimia, me pesë katedra, që kishte edhe shumicën në Dekanat, këshilli votoi për propozimin e prof. Pepit: “Katedra është njësi mësimore – shkencore”.

Dekada më vonë e kam kujtuar debatin e asaj mbledhjeje, kur kam qenë me bursën DAAD, në Universitetin e Darmstadt-it në Gjermani, dhe me porosi nga Fakulteti, mora shënim se si ishte atje procesi zgjedhor për postin e Dekanit. Nuk po fute në hollësi, por po ndalem vetëm në një fakt. Posti i Dekanit, ishte me kohëzgjatje 2 vjet. Por, profesorët nuk e preferonin postin e Dekanit, megjithëse zyrtarisht duhet të shkonin në zyrë vetëm tri herë në javë, të hënën, të mërkurën dhe të premten dhe të rrinin 4 orë: 8-12. Dhe e dini pse nuk e preferonin, mbasi nuk dëshironin që 12 orë javore t’i harxhonin për punë administrative.

Në mbledhjet që bëheshin me kuadrot drejtuese të Universitetit, në sallën e madhe të Rektoratit, në prani të udhëheqësve më të lartë të kohës, që mbulonin arsimin dhe shkencën, në emër të Fakultetit të Shkencave të Natyrës fliste prof. Pepi, që ishte vetëm shef katedre.

Prof. Pepi nuk i përket vetëm matematikës. Si një njeri me personalitet të spikatur, ai në gjithë jetën e tij inkurajoi dhe frymëzoi veprime dhe iniciativa që çonin vetëm në rritjen e cilësisë dhe dinjitetit të arsimit të lartë universitar.

15 vjet më parë, në një intervistë, që më morën në një gazetë, ndër pyetjet e shumta ishin, natyrisht, edhe ato që lidheshin me shkollimin. Brezi im, në etapa të ndryshme të shkollës, ka pasur mësues dhe pedagogë të mëdhenj për kohën. Unë përmenda mësuesin e rrallë dhe të paharruar të Fizikës të gjimnazit shumë të njohur Qemal Stafa të Tiranës. Nuk e përmenda me emër. Për këtë më vonë jam penduar. Por me përshkrimin që i bëra, të gjithë gjimnazistët e Qemal Stafës e kuptonin që ai ishte Fadil Repishti. Kur erdhi radha e shkollimit universitar, pa hezituat, e përmenda një emër. Dhe ai ishte profesor Petraq Pilika. Nuk e kam “tradhtuar” Fizikën, por ndërgjegjja më thoshte që ai e meriton.

I paharruar qoftë kujtimi i tij!



Përshëndetja

e prof. dr. Mishel Fundo, (online)

Për profesor Pepin!

Figura dhe kujtimi i profesor Pepit janë dhe mbeten gjithmonë të gjalla në përfytyrimin tonë. Ato janë mishërimi i forcës së pasionit dhe i talentit për matematikën dhe zhvillimin shkencor si dhe burim frymëzimi për ne dhe për brezat e ardhshëm.

Ne, që mund të përfshihemi në gamën e disa kuadrove relativisht më të hershëm, jemi dëshmitarë të të gjitha etapave dhe tablove më të rëndësishme të zhvillimit matematik, ku gjithnjë vendin qendror e kishte profesor Pepi, si në prodhimtarinë shkencore dhe punën edukative mësimore, ashtu edhe në modernizimin e degës, në çeljen e drejtimeve të reja dhe në zgjedhjen, në formimin dhe në mbrojtjen e një kuadri cilësor, i cili e përligji veten e vet si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kudo, poshtë dhe lart, fjala e Pepit kishte peshë, logjika e tij ishte e pakundërshtueshme dhe vendoste vulën.

Pata edhe unë privilegjin dhe fatin e madh të jetoja e të punoja në një kolektiv të mrekullueshëm njerëzish shumë të zot dhe të talentuar; pata edhe mundësinë të mësoj shumë nga mençuria dhe bota e tyre shpirtërore brilante. Në përfytyrimin tim modest më është ngulitur ideja që Pepi, profesor Pepi ishte unikal në forcën krijuese dhe pasionante për matematikën, në mbrojtjen me gjithë shpirt të pozitives e me shpirt të pa krahasueshëm sakrifice, shpesh pa llogaritur koston; por Pepin e kuptonin, e dinin që luftonte për të mirën dhe e dinin që ishte besnik i ideve të tij, ashtu siç ndodhi në të vërtetë.

Përulem me nderim të thellë para kujtimit të Pepit tonë të paharruar!



Fjala përshëndetëse

nga vajza e Pilikës, Leda Mëhilli (Pilika) në emër të familjes

Te dashur zonja dhe zotërinj, miq, ish studente të babait dhe profesorë të nderuar,

Në emrin e familjes tonë – në radhë të parë Arianës: mamasë tonë, vëllait tim Klit dhe familjes së tij, mua dhe familjes time – do të doja të shprehja mirënjohjen tonë të thellë dhe falënderimet më të ngrohta për prezencën në këtë ditë kaq domethënëse.

Falënderojmë nga zemra Akademinë e Shkencave, kryetarin e Akademisë së Shkencave, zotin Skënder Gjinushi, Komisionin e Përhershëm të Matematikës dhe Informatikës pranë Akademisë së Shkencave dhe Institutin Kombëtar të Matematikës për organizimin e kësaj konference, që na mbush plot me gaz, emocione në ditën e 100 vjetorit të lindjes së bashkëshortit, babait dhe gjyshit tonë të paharruar, Petraq Pilika.

Nuk kam dyshim që babai do të ishte dakord me mua për të thënë që kjo ngjarje dhe themelimi i çmimit Pilika me rastin e 100-vjetorit të lindjes është një nga dhuratat më të çmuara për të, por në mënyrë akoma më të rëndësishme për shkencën dhe matematikën shqiptare.

“Për çfarë vlen matematika? E dëgjojmë shpesh këtë pyetje mbi këtë disiplinë kaq kontradiktore – nga njëra anë plot me mistere, e vështirë / komplekse për t’i zbuluar sekretet, ku asgjë nuk është kurrë e fituar paraprakisht, por në të njëjtën kohë që pasionin dhe punën e shpërblen me kënaqësi të papërshkrueshme”.

Do të doja të shpreh 2-3 mendime të lira që uroj të jenë një përpjekje në përgjigje të kësaj pyetje legjitime dhe që të rezonojnë në sallë:

1. Matematika, kjo lëndë që na ka nxjerrë kaq djersë të ftohta është në të vërtetë “një muzikë e heshtur, ndërkohë që muzika është një matematikë me tinguj”;
2. Matematika na mëson metoda arsyetimi dhe përpikmërie pune dhe jete;
3. Pavarësisht nëse jeni matematikanë apo jo, matematika është e pashmangshme, pa të nuk do të ekzistonin një numër i pafund shpikjesh/arritjesh teknologjike,

industriale, mrekullish kulturore, artistike, arkitekturnale të botës ku jetojmë (për shembull : piramidat e Kheopsit pa gjeometrinë në hapësirë, financa moderne pa modelet matematike biblike, fenomeni i vrimave të zeza në hapësirë pa teorinë e relativitetit të Einsteinit).

Po, matematika është një festë...

Është kjo festë që babai përqafoi që në moshën më të vogël dhe të cilës i kushtoi dashurinë e tij më të madhe, një dashuri të përjetshme pa kushtëzim që nuk e zhgënjeu kurrë. Nuk jam në gjendje të shpjegoj as ditën, as orën e lindjes të këtij pasioni. Por diçka për të cilën jam shumë e sigurtë, ajo është fruti i një takimi, miqësie në qytetin e tij të lindjes Korçë që i la gjurmë të përjetshme.

Është fjala për kryqëzimin e rrugës të një djaloshi adoleshent, i etur për dije për shkencë, dhe patriotit, eruditit të shquar Raqi Qirinxhi, që i rrënjosi përgjithmonë dashurinë dhe vibracionin (dridhje) për matematikën. Babai kishte një përkushtim absolut për mjeshtrin e tij (me M të madhe), të cilit, ai i detyrohej gjithçka.

Babi e donte matematikën mbi të gjitha dhe ishte i bindur që matematika ja kishte kthyer këtë pasion shumë herë më shumë, pa deklarata të veçanta si një qenie e gjallë, por duke i ofruar bashkësi teoremash, problemesh për të zgjidhur, ndonjëherë të thjeshta dhe ndonjëherë me pak, por që gjithmonë i prokuruan një kënaqësi të pamasë, një kënaqësi që vetëm një dashamirës ose profesionist i pasionuar i shkencës mund të ndjejë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës dhe katedra e Matematikës e Specialitetit që ai drejtoi si dhe realizimet premtuese në buletinet shkencore të kohës ishin krenaria e përditshme e tij. Por, lumturia e tij më e lartë për të cilën ishte shumë bujar në lavdërime, dhe ku shkonte gjithë mirënjohja e tij ishin kolegët, bashkëpunëtorët e tij dhe katedra e matematikës – familja e tij paralele.

Ishin këta kolegë që ja shpërblenin çdo ditë, orë, minutë në mënyrën më elegante këtë përkushtim duke e thirrur “Usta”. Ata a shoqëruan gjatë gjithë jetës së tij dhe për babin kjo ishte arritja më e madhe.

Kujtoj me respektin më të madh :

- Profesor Aleka Minga, që në sytë e mi mbeti një nga ikonat dhe monumentet e matematikës dhe polivalencës shkencore dhe kulturore shqiptare.
- Gjenerata të tëra matematicienësh dhe shkencëtarësh të shquar – profesor Osman Kraja, profesor Shaban Baxhaku, profesor dhe akademikun Skënder Gjinushi,

Maksi Raço, Llukan Puka, Mina Naço, Agim Karçanaj, Kujtim Dedej, Mishel Fundo, Çezar Teliti, Fatmir Hoxha dhe shumë të tjerë të cilëve ju kërkohet ndjesë që nuk mund t'i përmend, të cilët vazhduan dhe vazhdojnë trashëgiminë e matematikës, flaka e së cilës nuk do të shuhet kurrë.

Jam e bindur që babai – nga lart – po na vëzhgon krenarisht sot. Në erën e Inteligjencës Artificiale dhe realiteteve numerike, matematika dhe shkenca do të vazhdojnë ecjen e tyre shumë më përpara se ç'e kemi ëndërruar. Kjo konferencë dhe ky çmim janë një dëshmi reale e këtij vrulli progresist.

Do të doja ta mbyllja këtë falënderim familjar me këtë citim të babait tim që mendoj se e kishte filozofinë e jetës së tij:

“ Unë jam njeriu më i lumtur në botë, sepse kam qenë gjithmonë i rrethuar nga njerëz të zotë”.

Ju faleminderit!



Prof. asoc. Besiana Çobani

Të nderuar profesorë, kolegë dhe miq,

Së pari dëshiroj të falënderoj Akademinë e Shkencave për organizimin e konferencës së mbajtur në nderim të figurës dhe kujtimit të profesor Petraq Pilika, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij.

Shpreh mirënjohjen time të thellë për profesorët e nderuar që vlerësuan tezën time të doktoratës me çmimin e veçantë shkencor “Pilika” për “doktoratën më të vlerësuar të studiuesve të rinj shqiptarë, mbrojtur dhe publikuar gjatë periudhës 2010-2023”.

Marrja e këtij çmimi është një motivim i jashtëzakonshëm për mua që të çoj përpara punën time kërkimore shkencore.

Dëshiroj të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen time ndaj udhëheqëses sime të doktoratës, prof. Fioralba Cakoni, e cila më mori nën udhëheqje pa hezitimin më të vogël me synimin e qartë të saj për të përgatitur në departamentin e Matematikës, FSHN doktratura që janë në nivel të njëjtë me universitetet prestigjioze botërore, ku prof. Cakoni është e angazhuar.

E falënderoj në veçanti prof. Cakonin për mundësitë që më dha për t’u njohur me profesorë të nderuar të fushës së ekuacioneve me derivate të pjesshme dhe për literaturën bashkohore që ma mundësonte në çdo kohë.

Ju falënderoj dhe ju përgëzoj për këtë iniciativë kaq motivuese për kërkuesit shkencorë dhe uroj që Departamenti i Matematikës të eci në gjurmët që kanë lënë profesorët e nderuar Petraq Pilika, Mishel Fundo, Osman Kraja, Shaban Baxhaku, Petraq Petro, Aleko Minga, sepse janë gjurmë që çojnë drejt një rruge të sigurt suksesi.

Me shumë respekt dhe mirënjohje!



Prof. asoc. Kastriot Zoto

Të nderuar profesorë, ndjehem i vlerësuar me marrjen e këtij çmimi për vetë faktin se ky çmim mban një emër të madh të matematikës, emrin e profesorit të nderuar dhe të paharruar “Petraq Pilika”. Eshtë ai, që e lindi dhe krijoi katedrën e Matematikës, Departamentin e Matematikës, dhe i dha emrin e tij duke iu përkushtuar gjithë jetën kësaj fushe kaq të bukur e abstraguese me të cilën merret pothuaj një brez i tërë matematikanësh e studiuesish.

Vlerësoj Akademinë e Shkencave, veçanërisht profesorin e nderuar Skënder Gjinushi, Institutin e Matematikës në mënyrë të veçantë profesor Fatmir Hoxhën për iniciimin e kësaj konference dhe për iniciimin e vlerësimin e punës kërkimore shkencore në fushën e matematikës për një brez të rinj studiuesish që vazhdojnë të merren edhe sot.

Një falënderim tjetër dëshiroj të jap për profesorin e nderuar Xhezair Teliti dhe profesoren e nderuar Elida Hoxha, të cilët kanë inicuar rrugëtimin tim qysh para 12 vitesh, duke më dhënë besimin dhe mbështetjen me studimet e doktoratës e më pas në punën tonë, në fushën e matematikës që është një punë që e bëjmë pa financim, por me dëshirë e pasion. Dhe matematika prandaj është e bukur kur ajo bëhet me pasion e dëshirë.

Dua të falënderoj gjithashtu të gjithë ata kolegë të rinj, që u nominuan në marrjen e këtij çmimi. I vlerësoj dhe i përgëzoj për punën e rezultatet e arritura në fushën e matematikës.

Faleminderit të gjithëve!



Prof. Aleko Minga

Të nderuar miq, shokë dhe kolegë, pjesëmarrës në këtë ceremoni në nderim të 100 vjetorit të profesorit tonë të shquar, Petraq Pilikës.

Ishte një dëshirë e të gjithëve për të përjetësuar emrin e tij. Dhe mënyra më e goditur për ta përjetësuar këtë emër ishte pikërisht ajo që u zgjodh nga Akademia e Shkencave dhe nga prof. Gjinushi, që u bë iniciator, për krijimin e një çmimi që mban emrin e tij, çmim i cili duhet të ruajë reputacionin vazhdimisht, në mënyrë që të jetë në lartësinë e këtij emri jashtëzakonisht të madh.

Me profesor Pilikën unë kam bashkëpunuar më tepër se një gjysmëshekulli. Jam përpjekur t'ia lehtësoja paksa barrën e punëve burokratike që kërkoheshin atëherë. Por kjo është një gjë pambarimisht e vogël në krahasim me atë përfitim që kam pasur prej tij. Sepse, ai si vëzhgues i mprehtë i realitetit, si njeri që dinte t'i analizonte me logjikë të thellë ngjarjet, kur fillonte monologët e tij, mbetësha me gojë hapur dhe me të vërtetë kam përfituar në mënyrë të jashtëzakonshme prej tij. E kam ndjekur edhe në punën tjetër, se si kujdesej që kolektivi i katedrës së matematikës të ishte një kolektiv shembullor, siç u bë vërtetë në të tërë universitetin. Dhe kjo nuk është sepse e lëvdojmë ne, por sepse ai vërtetë e kishte këtë reputacion. Prof. Pepi kishte aftësi që prej secilit të nxirrte potencialin intelektual që kishte brenda vetes. Dhe, duke u ngarkuar detyra të ndryshme e të posaçme, arriti që ta bënte atë katedër me të vërtetë shembullore.

Ç'të thuash për të? Mund të përmend krijimin e pesëvjeçarit dhe luftën që ka bërë ai, që ky drejtim të mbetej, sepse pesëvjeçarin e luftonin, gjoja parimisht, sepse thoshin që ky do të ishte një arsim elitari. Mënyra se si e mbrojti prof. Pepi atë, ishte me të vërtetë e mahnitshme.

E ç'të kujtosh tjetër për të? Ju i thatë të gjitha në këtë ceremoni të mrekullueshme dhe mua më mbetet vetëm të përgjunjem përpara kujtimit të dashur të tij.

Ju falënderoj në mënyrë të posaçme për çmimin që më akordoni sot, me emrin e tij, të cilin unë do ta mbaj si një relike të çmuar për tërë jetën time.

Më vjen keq që nuk vij ta marr dot personalisht, por ju përsëndes të gjithëve dhe ju uroj shëndet, mbarësi, suksese e gjithë të mirat, për të mirën e shkencës shqiptare.